



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada-Government**

**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**

Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of  
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

**DPL.nr.13/2021**

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, Diellza Hoxha dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit, në çështjen disiplinore ndaj përmbarduesit privat z. [REDACTED], si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në [REDACTED] i dyshuar për shkelje disiplinore gjatë veprimeve përmbardimore në lëndën përmbardimore [REDACTED] pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezentuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, znj. Burbuqe Spahija, në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore, palës ankuese, përfaqësuesit të Divizionit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës për Profesione të Lira dhe përmbarduesi privat, z. [REDACTED] dhe pas seancës këshillimore, me datën 15.07.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Organi përmbardues-Përmbarduesi Privat z. [REDACTED] i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në [REDACTED] është përgjegjës për shkelje disiplinore nga neni 367 par 1, pika 1.2 të LPP-së.
- II. Për kryerjen e kësaj vepre disiplinore, përmbarduesi privat, z. [REDACTED] i shqiptohet masa disiplinore "gjobë në të holla," në shumën prej 500 € (pesëqind Euro) e paraparë me nenin 368 par 1, pika 1.3 të LPP-së.
- III. Detyrohet përmbarduesi privat, z. [REDACTED] që të bëjë pagesën në emër të gjobës së shqiptuar me këtë vendim, në llogarinë bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës, brenda afatit prej një (1) muaji duke e llogaritur nga dita e dorëzimit të këtij vendimi përmbarduesit privat.



## A r s y e t i m

Me datën 25.05.2021, Divizioni për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës për Profesione të Lira (tash e tutje Divizioni) ka dorëzuar në Departamentin për Profesione të Lira-Divizionin për Përmbarrim Privat, Raportin nr 15/21 dhe Procesverbalin në kryerjen e mbikëqyrjes/inspektimit të ligjshmërisë së punës së përmbaruesit privat z. [redacted] i lidhur me lëndën [redacted] sipas ankesës/kërkesës dt 30.03.2021 të [redacted] si palë debitore. Sipas Raportit të Divizionit bazuar në pretendimet e palës ankuese, përmbarimi ishte bërë në bazë të dokumentit i cili nuk është i besueshëm në kundërshtim me nenin 21 të LPP. Konkretisht, Raporti thekson që Përmbarrimi në këtë rast është lejuar me dt 17.06.2020 nga ana e përmbaruesit privat ndaj debitorit [redacted] mbi bazën e marrëveshjes e dt 09.10.2018 dhe kartelës financiare të kreditorit dhe debitorit. Kjo marrëveshje sipas Raportit, përbën vetëm një marrëveshje interne e cila është nënshkruar vetëm nga përfaqësuesit e kompanive dhe katër (4) dëshmitarëve.

Me datën 01.06.2021, Ministria e Drejtësisë -Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, ka paraqitur në Komisionin propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat z. [redacted] si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në [redacted] dhe në përputhje me nenin 373 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, ka propozuar që të ndërmerren veprimet e nevojshme lidhur me këtë lëndë.

Përmbaruesi privat z. [redacted] në përgjigjen e tij me shkrim dt 17.06.2021 deklaron që propozimi për iniciimin e procedurës disiplinore është bërë në kundërshtim me nenin 375 të LPP pasi "procedura disiplinore mund të fillohet brenda afatit prej gjashtë (6) muaj nga dita e shkeljes së bërë" kurse në rastin konkret nga momenti i shkeljes së supozuar e deri në momentin e inicimit të kësaj procedure ka kaluar afati prej një (1) viti. Shton se shkaqet për iniciimin e kësaj procedure disiplinore sipas raportit të Ministrisë së Drejtësisë hyjnë në domenin e nenit 71 par 1 të LPP dhe për këtë do të duhej të deklarohet Gjykata Themelore kompetente e në asnjë mënyrë Komisioni Disiplinor. Sipas përmbaruesit privat, debitori ka ushtruar prapësim kundër urdhrin për përmbarrim [redacted] brenda afatit ligjor por me vullnetin e tij të lirë ka njoftuar përmbaruesin privat në zyrën e kësaj të fundit se ka arritur marrëveshje me kreditorin dhe në këtë mënyrë ka tërhequr prapësimin. Po ashtu, përmbaruesi thekson se Divizioni nuk ka kompetencë të iniciojë procedurë disiplinore sepse ligjshmërisa shqyrtohet nga ana e gjykatës. Përmbaruesi privat pretendon se parakusht i nevojshëm për iniciimin e procedurës disiplinore është vendimi i gjykatës themelore mbi prapësim i cili konstaton shkeljen. Po ashtu, përmbaruesi privat thekson se procedura disiplinore nuk mund të inicohet pa iu dhënë mundësia vet përmbaruesit privat që t'i sanojë shkeljet eventuale.

Me datën 15.07.2021, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, znj. Burbuqe Spahija, në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore, përfaqësuesi i Divizionit të Ministrisë së Drejtësisë, pala ankuese si dhe përmbaruesi privat, z. [redacted]



Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, znj. Burbuqe Spahija, ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbarruesit privat duke theksuar se mbetet pranë propozimit. Po ashtu përfaqësuesi i Divizionit të Ministrisë së drejtësisë ka ngelur pranë Raportit të paraqitur me shkrim si dhe ka bërë elaborimin e saj. Përmbarruesi privat gjithashtu ka paraqitur qëndrimin e tij lidhur me pretendimet e ngritura.

Në cilësi të provave materiale, Komisioni ka administruar si në vijim: Raporti për kryerjen e mbikëqyrjes/inspektimit të ligjshmërisë së punës së përmbarruesit privat dt 31.05.2021, Raporti për kryerjen e mbikëqyrjes/inspektimit të ligjshmërisë së punës së përmbarruesit privat dt 25.05.2021, Procesverbali për inspektimin e ligjshmërisë së punës së përmbarruesit privat, Propozimi për përmbarrim dt 17.06.2020, urdhëri përmbarrimor [REDAKTUAR] dt 17.06.2020, Marrëveshja mbi shitblerjen e dt 09.10.2018, Kontrata dt 09.10.2018, Kontrata e dt 26.10.2019, Marrëveshja për rregullimin e obligimeve mes palëve me nr [REDAKTUAR] marrëveshja për rregullimin e obligimeve mes palëve me nr [REDAKTUAR] marrëveshja për shlyerje të obligimit dt 30.12.2019, prapësimi dt 29.06.2020, kërkesa për vërtetim të bazës ligjore drejtuar Odës së Përmbarruesve Privat të Kosovës, Përgjigjja e Odës së Përmbarruesve Privat të Kosovës. Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se përmbarruesi privat z. [REDAKTUAR] në këtë lëndë disiplinore ka kryer shkelje disiplinore.

Komisioni gjen me rëndësi të thekson se në rastin konkret, procedura disiplinore është inicuar brenda afatit ligjor. Neni 375 i LPP-së, shprehimisht përcakton që *“procedura disiplinore (ndaj përmbarruesit privat theksimi i shtuar) mund të fillohet brenda afatit prej gjashtë (6) muaj nga dita e shkeljes së bërë, por jo më vonë se një (1) vit nga dita e shkeljes.”* Kjo do të thotë se procedura disiplinore më së voni mund të fillohet brenda një (1) viti nga dita e shkeljes së pretenduar disiplinore. Në këtë rast, përmbarrimi është lejuar me dt 17.06.2020 me urdhërit përmbarrimor P. [REDAKTUAR], kurse procedura disiplinore ndaj përmbarruesit pranë komisionit disiplinor formalisht është inicuar me datën 01.06.2021, ku Ministria e Drejtësisë -Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, ka paraqitur në Komision propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbarruesit privat z. [REDAKTUAR], në përputhje me nenin 373 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, si dhe ka propozuar që të ndërmerren veprimet e nevojshme lidhur me këtë lëndë. Rrjedhimisht, rasti është inicuar para kalimit të periudhës prej një (1) viti. Përsa i përket kompetencës së organit për inicimin e procedurës disiplinore, Komisioni gjen se neni 359 par 1 i LPP-së shprehimisht përcakton se *“mbikëqyrjen ndaj ligjshmërisë së punës së përmbarruesit privat dhe të Odës e kryen Ministria ndëpërmjet të përsoneve të autorizuar (inspektorëve) të Ministrisë.”* Po ashtu edhe më akte nën ligjore siç është Rregullore QRK – nr. 12/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores QRK– nr. 31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, është përcaktuar organizimi dhe funksionimi i organeve brenda Ministrisë, në këtë rast e Divizionit, për mbikëqyrjen e punës së përmbarruesve privat. Rrjedhimisht, Komisioni nuk gjen asnjë pengesë që procedura disiplinore të inicohet nga Ministria përkatësisht divizioni përkatës.

Komisioni gjen se në rastin konkret përmbarruesi privat kishte inicuar procedurën përmbarrimore mbi bazën e dokumentit i cili nuk është i besueshëm dhe në kundërshtim me nenin 21 të LPP-së. Me nenin 22 të LPP-së janë përcaktuar se cilat dokumente janë dokumente përmbarruese. Ligji

liston dokumentet e tilla në mënyrë të saktë. Ndryshe nga ajo të cilën e parasheh ligji. Përmbaruesi privat kishte lejuar përbarimin me dt 17.06.2020 ndaj palës debitore [REDACTED] [REDACTED] mbi bazën e marrëveshjes e dt 09.10.2018 dhe kartelës financiare të kreatorit dhe debitorit. Kjo marrëveshje padyshim përbën vetëm një marrëveshje interne mes palëve e cila është nënshkruar vetëm nga përfaqësuesit e kompanive respektive dhe katër (4) dëshmitarëve. Fakti se kjo marrëveshje nuk ishte noterizuar sipas procedurave ligjore, e bënë dokumentin ligjërisht të papërmbarueshëm. Përkundër që palët kanë hequr dorë nga prapësimi dhe kanë arritur marrëveshje për përmbushje të detyrimit, fakti që ky veprim përbarimor ishte ndërmarr nga ana e përmbaruesit privat në kundërshtim me ligjin përbën në vlerësimin e Komisionit shkelje disiplinore.

Komisioni vlerësoi se masa e shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë disiplinore të përmbaruesit, është e mjaftueshme dhe në përputhshmëri me karakteristikat rastit konkret si dhe në pajtim me parimin e proporcionalitetit, dhe i njëjti do të ndikojë në përmbaruesin si dhe tek përmbaruesit tjerë që t'u përmbahen dispozitave ligjore në përmbushjen e mandatit ligjor në ofrimin e shërbimeve përbarimore në mënyrë profesionale dhe objektive, çka, në thelb, është edhe qëllimi i masës.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**  
**DPL.nr 13/2021, datë 15.07.2021**

**Kryesues i Komisionit Disiplinor**  
**Adnan ISUFI**



**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.